



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1517/4 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

VENDIM

Nr.196, datë 23.12.2019

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 81, DATË 25.09.2018, NË
INSTITUCIONIN DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 81, datë 25.09.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 32, datë 16.04.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 81, datë 25.09.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, konstatohet se, situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, të konstatohet menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 1173, datë 25.05.2017, të punonjësës ***** , me detyrë *“Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë”*.

Konstatohet se, me Urdhrin nr. 3149, datë 31.08.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës është vendosur lirimi i punonjësës duke zbatuar rekomandimin sipas orientimit të lënë në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe në Vendimin Paralajmërues, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka lënë detyrë që pozicioni i punës *“Arkivist”*, pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë, të konsiderohet si pozicion pune pjesë e shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe të reflektohet në strukturën e institucionit.

Vërej se, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 3755 prot., datë 14.11.2018, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike, për zbatimin e sa më sipër. Njësia përgjegjëse, DAP, me shkresën nr. 8183/1 prot., datë 24.12.2018, *“Kthim përgjigje suajës nr. 3755 prot., datë 14.11.2018”* është shprehur se, i takon Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës të vlerësojë nëse pozicioni i punës *“Arkivist”*, pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë, duhet të përfshihet në shërbimin civil. Si rrjedhim, DAP ka kërkuar që, në rast të një vlerësimi pozitiv nga ana e institucionit, të përcjellë pranë tij draft-strukturën, së bashku me relacionin përkatës, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme, qëndrim të cilin ia ka përcjellë edhe Komisionerit me shkresën nr. 1365/1 prot., datë 14.10.2019, e protokolluar pranë këtij të fundit me shkresën nr. 1517 prot., datë 15.10.2019.

Në vijim, Komisioneri me shkresën nr. 1517/1 prot., datë 23.10.2019, i ka kërkuar informacion institucionit të mbikëqyrur. Në përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me shkresën nr. 1552 prot., datë 05.11.2019, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 26 prot., datë 10.01.2019, me objekt: *“Kthim përgjigje shkresës me nr. 1517/1 prot., datë*

23.10.2019”, ka sqaruar se, institucioni është në proces ristrukturimi dhe me përfundimin e këtij procesi, do të ndryshojë edhe struktura e institucionit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në zbatim të detyrës së materializuar në pikën 4, të vendimit paralajmërues nr. 81, datë 25.09.2018, njësia përgjegjëse DAP, duhet të shprehet në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit “*nëpunës civil*”, për punonjësen *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”.

Rezulton se, në zbatim të kërkesave të nenit 67, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar*”, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 3341 prot., datë 27.09.2018, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe me aktin nr. 6971/1 prot., datë 15.10.2018, të DAP është nxjerrë “*Akti i Deklarimit të statusit të punësimit*” për punonjësen në fjalë.

Në lidhje me detyrën e lënë njësisë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, për përfundimin e procesit të hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, pika 5, e vendimit paralajmërues.

Vërej se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore me përfundimin e procesit të hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil, pranë institucionit të mbikëqyrur dhe pas komunikimit me Departamentin e Administratës Publike, me shkresën nr. 3782 prot., datë 20.11.2018, i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar që të bëhet nënshkrimi i përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune të shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Në vijim të këtij procesi, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 1552 prot., datë 05.11.2019, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 26 prot., datë 10.01.2019, ka sqaruar se, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës është në proces ristrukturimi. Me përfundimin e këtij procesi do të ndryshojë struktura e institucionit e si rrjedhim do të rishikohen përshkrimet e punës në përputhje me strukturën e re, duke respektuar kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në pikën 6 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë, për njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, sistemimi i dosjeve të personelit, duke i organizuar dhe plotësuar sipas përcaktimeve të lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të*

personelit e të regjistrit qendror të personelit”, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në raportin përfundimtar.

Nga praktika shkresore, rezulton se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në zbatim të detyrës së lënë në vendimin paralajmërues të Komisionerit ka plotësuar dosjet e personelit të çdo nëpunësi sipas lidhjeve nr. 1 dhe 2, pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 117, datë 05.03.2014. Gjithashtu, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 3781 prot., datë 20.11.2018, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për statusin aktual të gjendjes gjyqësore për punonjësit e Shërbimit të Provës. Në përgjigje Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 2969/1 prot., datë 05.12.2018, me objekt: *“Kthim përgjigje”*, ka bërë verifikimin në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore, duke vënë në dispozicion edhe vërtetimet e gjendjes gjyqësore. Aktualisht, dosjet e personelit janë në gjendje të mirë dhe administrohen nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion.

Duke vlerësuar punën e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 81, datë 25.09.2018, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 81, datë 25.09.2018.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha